

Muhamed ibn Ibrahim El Hamed

j

**PAKUJDESIA NË EDUKIMIN
E FËMIJËVE**
dukuritë dhe mënyrat e mbrojtjes

Shkup
1428/2008

Titulli i origjinalit (arabisht): *Et teksiru fi terbijetil evladi*

Përshtatën nga arabishtja: Studentët e vitit të -IV- të FSHI-së – Shkup
Gjenerata e tetë 2007-2008

Përkthyesit:

Shenaje Ganiu
Nermine Ganiu
Mensire Halili
Firdeze Selmani
Irfan Musliu
Miftar Islami
Avni Asani
Jusuf Imeri
Sadem Bajrami

Recensent: Mr. Naser Ramadani
Ziber Lata

Lektor: Agim Avdiu

Përgatitja kompjuterike: Besnik Hamiti

Botuesi: Unioni i Studentëve të FSHI-së

Botimin e këtij libri e ndihmoi xhemati i xhamisë së Flumsit - Zvicër.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Gjithëmëshirshmit

وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي هَدَانَا لِهَذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ لَوْلَا أَنْ هَدَانَا اللَّهُ

“Ata thonë: “Falënderojmë All-llahun që na udhëzoi për këtë (për iman, për punë të mira, na e hoqi zilinë, na futi në xhennet), pse sikur të mos na drejtonte All-llahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi”

(El-A'raf, 43).

Muhamedi (*sal-lallahu alejhi ve sel-lem*) ka thënë:

“Secili prej jush është bari dhe përgjegjës ndaj obligimeve... burri është bari në familjen e tij dhe përgjegjës ndaj tyre”.

Transmeton Buhariu (583) dhe Muslimi (1829).

PARATHËNIA E PËRKTHYESVE

d

Falënderimi i plotë i takon vetëm Allahut xh.sh., Zotit të botëve, përhëndetjet dhe paqja qofshin mbi më të vyeshmin prej pejgamberëve, familjen dhe shokët e tij në përgjithësi.

Gjatë studimit tonë në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, kemi mësuar se islami është sistem jete, që do të thotë se rregullon jetën e njeriut në gjitha çështjet dhe sferat. Mes tjerash kemi mësuar se qëllimi kryesor i dërgimit të pejgamberëve dhe i zbritjes së librave është edukimi i njeriut. Periudha të cilës më së shumti duhet t'i kushtohet kujdes për edukimin e njeriut është periudha rinore ose thënë ndryshe edukimit të fëmijëve. Andaj ky libër i tregon dëmet e moskujdesit të edukimit të fëmijëve dhe mënyrat e mënjanimit të këtyre dukurive negative.

Ky përkthim është pjesë e punës praktike në lëndën e gjuhës arabe.

Lusim Allahun xh.sh. që ky libër të na sjellë dobi së pari neve, mandej prindërve dhe të gjithë atyre që e lexojnë.

HYRJE

d

Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej veseve dhe veprave tona të këqija. Cilin e udhëzon All-llahu s'ka kush që e lajthit dhe cilin e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush që e udhëzon. Dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç All-llahut, i Cili është Një i pashoq dhe dëshmoj se Muhammedi a.s. është rob dhe i Dërguari i Tij. Salavatet dhe selamet qofshin mbi të dërguarin e All-llahut.

Fëmijët janë emanet në supet e prindërve, ndërsa prindërit janë përgjegjës për këtë emanet, kështu që mangësia në edukimin e fëmijëve është çrregullim i qartë, gabim katastrofal, tradhti e emanetit dhe mangësi fetare.

Sa i përket shtëpisë, ajo është shkolla e parë e fëmijëve dhe tulla nga e cila formohet e tërë shoqëria. Në një familje të udhëzuar bujare, në të cilën ekziston përkujdesja për urdhërat e prera të All-llahut xh.sh., ku zbatohen ligjet e Tij dhe e cila është ngritur mbi shtyllat e dashurisë, harmonisë, mëshirës, bashkëpunimit dhe devotshmërisë, aty zhvillohen burrat, gratë, prijësit dhe udhëheqësit e këtij populli.

Fëmija para se të edukohet në shkollë dhe në shoqëri, ai duhet të edukohet në familje dhe në shtëpi. Ai u mbetet borxh prindërve në moralin e drejtë shoqëror dhe për devijimin e tij moral.

Ibn Kajjimi (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

“Sa e sa njerëz janë që i kanë humbur fëmijët e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër nga pakujdesia dhe nga mosedukimi i tyre. Prindërit ndonjëherë i nxisin epshet e tyre duke supozuar se i respektojnë ata, mirëpo në të vërtetë ata i nënçmojnë dhe u bëjnë padrejtësi atyre duke menduar se i mëshirojnë. Nëse i shikoni fëmijët e devijuar, do të shihni se te pjesa dërmuese e tyre, shkaktarë të devijimit të tyre janë pikërisht prindërit.”

Biseda në këtë temë do të jetë rreth pakujdesisë (neglizhencës) në edukimin e fëmijëve, duke i përfshirë pikat në vazhdim:

- **Tërheqja e vërejtjes ndaj pakujdesisë në edukimin e fëmijëve,**
- **Disa dukuri të pakujdesisë dhe gabime në edukimin e fëmijëve,**
- **Pyetje dhe përgjigje,**
- **Forma të ndryshme (shembullore) rreth edukimit të fëmijëve nga gjeneratat e para,**
- **Teprimi,**
- **Mënyrat e edukimit të fëmijëve,**

Më në fund e lusim All-llahun xh.sh. me emrat e tij të bukur dhe me vetitë e Tij të larta që të na përmirësojë neve dhe pasardhësit tanë.

PËRKUJDESJA NGA MANGËSITË NË EDUKIMIN E FËMIJËVE

d

Fëmijët kanë obligime ndaj prindërve të tyre ashtu sikurse edhe prindërit ndaj tyre. Gjithashtu, Allahu na ka urdhëruar që të jemi bamirës ndaj fëmijëve, ashtu siç na ka urdhëruar të që kemi respekt dhe të jemi të mëshirshëm ndaj prindërve. Bamirësia ndaj tyre dhe përkujdesja ndaj edukimit të fëmijëve është zbatim i emanetit, ndërsa shkujdesja dhe anashkalimi i të drejtave të tyre është vjedhje dhe tradhti.

Ekzistojnë shumë tekste nga Kur'ani dhe Suneti që urdhërojnë bamirësinë ndaj fëmijëve dhe zbatimin e emanetit ndaj tyre, gjithashtu në të njëjtën kohë na e tërheqin vërejtjen që të mos i anashkalojmë dhe të mos jemi të pakujdesshëm ndaj tyre. All-llahu xh.sh thotë:

“All-llahu ju urdhëron që t’ua jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni.” (En-Nisa, 58)

Po ashtu, Zoti xh.sh. thotë:

“O ju që besuat, mos e tradhtoni All-llahun dhe të dërguarin e ashtu të tradhtoni amanetet tuaja, derisa e dini sa e keqe është kjo.”

(El-Enfal, 27)

“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar.”

(Tahrim, 6)

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Secili prej jush është bari dhe përgjegjës ndaj obligimeve. Imami (prijësi) është bari dhe përgjegjës ndaj popullit dhe burri është bari në familjen e tij dhe përgjegjës ndaj tyre.”¹ Dhe tha: “Çdo rob të cilin All-llahu e ngarkoi me një obligim përgjegjës dhe ai vdes në atë ditë kur vdes dhe ai, ka vjedhur në udhëheqësinë e tij dhe ka mashtruar, All-llahu xh.sh. do t’ia ndalojë atij hyrjen në Xhennet.”²

¹ Sahihul Buhari, 583 dhe Muslimi, 1829.

² Sahihul Buhari, 112/13 dhe Muslimi, 142.

DUKURITË QË TREGOJNË MANGËSI DHE GABIM NË EDUKIMIN E FËMIJËVE

d

Edhe pse përgjegjësia ndaj fëmijëve është shumë e madhe, megjithatë shumë njerëz në lidhje me këtë çështje janë të pakujdesshëm. Ata i kanë tejkalluar kufijtë duke e konsideruar edukimin e fëmijëve si të pavlerë dhe duke mos ju kushtuar atyre kujdes të veçantë. Në këtë mënyrë, ata i kanë humbur fëmijët dhe e kanë lënë pas dore edukimin e tyre, as nuk pyesin, as nuk interesohen për ta dhe as nuk i orientojnë ata në rrugën e drejtë. Pastaj, prindërit fillojnë të qahen dhe të ankohen për këtë devijim, ndërsa nuk e dinë se ata janë shkak kryesor në padëgjueshmërinë dhe në devijimin e tyre.

Kështu thuhet në poezi:

E ka hedhur në lum me duar të lidhura,

Dhe kij kujdes mos lagesh! - i tha atij.

Mangësitë në edukimin e fëmijëve kanë forma dhe dukuri të ndryshme, të cilat shkaktojnë devijim dhe padëgjueshmëri ndaj prindërve. Disa prej tyre do t'i përmendim në vazhdim³:

1. Rritja dhe edukimi i fëmijëve në gjendje frike

Prej gjërave që vërehen gjatë edukimit të fëmijëve është edhe frikësimi i tyre kur ata qajnë, kështu që ne i frikësojmë ata me gjëra të trishtueshme, si p.sh. shtriga, vjedhësi, shejtani etj.

Më e keqja e gjithë kësaj është kur ne fëmijët i frikësojmë prej mësuesit, shkollës, mjekut etj. Në këtë mënyrë fëmija rritet si frikacak dhe frikësohet prej hijes së tij dhe prej gjërave prej të cilave nuk duhet të ketë frikë.

Më së shumti frikën në shpirtin e fëmijës e mbjell qortimi ndaj tij kur ai rrëzohet, kur i del gjak prej fytyrës, dorës apo gjunjëve. Në vend që e ëma të buzëqeshet dhe ta qetësojë fëmijën në mënyrë që ai ta kalojë lehtë këtë situatë, ajo e trishton duke e rrahur dhe duke i rënë me shuplakë. Po ashtu nëna mbjell ndjenjën e frikës duke e rrahur gjoksin, duke kërkuar ndihmë nga anëtarët tjerë të familjes dhe duke e zmadhuar problemin, kështu që fëmija fillon të qajë më shumë dhe te ai krijohet ndjenja e frikës dhe e dhimbjes kur shohin gjak.

2. Edukimi i fëmijëve me kryelartësi dhe me fyerje ndaj të tjerëve, por tërë këtë duke e quajtur trimëri.⁴

Kjo formë është e metë në edukim dhe e kundërta e të parës, ndërsa e vërteta është mesatarja.

³ Shih: Mustafa Sibai, Ehlakunal ixhtimajijetu, f. 155; Abdullah Kadrij, Etherut terbijetil islamijjeti fi emnil muxhtemei, f. 168-191.

⁴ Shih: Sabri Shahin, Vekefatun meal usreti, f. 12.

3. Edukimi i fëmijëve në anarki dhe harxhime të pakontrolluara

Nëse fëmija rritet dhe zhvillohet në një ambient komod dhe dëfryes, atëherë atij do t'i interesojë vetëm vetja, ashtu që ai nuk do të brengoset për hallin e të tjerëve, nuk do të pyesë aspak për vëllezërit tij myslimanë dhe nuk do ta ndajë as gëzimin dhe as hidhërimin me ta.

Pra, edukimi i fëmijëve në këtë frymë ua shkatërron natyrën e pastër Islame, vendosmërinë, njerëzoren dhe trimërinë.

4. Shtrirja e dorës ndaj fëmijëve duke u dhënë çdo gjë që dëshirojnë

Disa prindër u ofrojnë fëmijëve gjithçka që kërkojnë dhe janë dorëlëshuar ndaj tyre, kurse fëmijët e keqpërdorin pasurinë duke e shpenzuar atë në dëfrim dhe në gjëra të kota. Veprat e këtilla e paqartësojnë vlerën e pasurisë dhe e humbin mirëmenaxhimin e saj të fëmijët.

5. Prej gjërave që shkaktojnë devijim është përmbushja e kërkesës së fëmijës kur ai qanë, në veçanti kur ata janë të vegjël

Shpesh ndodh që të vegjëlit të kërkojnë prej prindërve diçka, nëse prindërit refuzojnë t'ia japin, ata fillojnë të qajnë derisa ta realizojnë qëllimin e tyre. Kështu që prindërit i nënshtrohen kërkesës së tyre, qoftë prej butësisë, mëshirës apo me qëllim që t'i heshtin ata, mirëpo një nënshtim i tillë është e metë dhe te fëmijët shkakton dobësi dhe çrregullim.

Dr. Muhammed El-Sibag thotë: “Kam dëgjuar prej Malik bin Nebiut (All-llahu e mëshiroftë), se një person kishte ardhur te ai për t'u konsultuar për edukimin e fëmijës së porsalindur. Maliku e pyeti: “Sa vjeç është fëmija?” “Një muaj” - iu përgjigj pyetësi. Atëherë, dr. Muhammed Sibagu i tha: “Të ka ikur treni, sepse që në fillim kur fëmija ka qarë dhe kur e ëma i ka dhënë të pijë qumësht, kështu ai ka përfitur bindjen se qarja është mjet për t'i realizuar kërkesat.”⁵

6. Blerja e veturave për ta që në vegjëli

Disa prindër u blejnë fëmijëve vetura që në vegjëli, sepse ata këmbëgulin në kërkesën e tyre apo për shkak se prindërit dëshirojnë që të lirohen nga kërkesat e shumta të shtëpisë duke i hedhur ato mbi supet e fëmijëve apo për shkaqe tjera.

Fëmija që në momentin e posedimit të makinës, në të shumtën e rasteve e fillon rrugën e devijimit, qëndron deri në orët e vona të natës, i shpeshton daljet nga shtëpia dhe fillon të lidhet me shoqërinë e keqe. Madje fillon t'i shqetësojë edhe njerëzit me zhurmën e veturës dhe ai fillon të mungojë në shkollë.

Në këtë mënyrë bëhet i padëgjueshëm ndaj prindërve, vështirësohet mbajtja e tij nën kontroll dhe vështirësohet udhëzimi i tij.

⁵ Nadheratun fil usretil muslimeti, f. 146-147.

7. Vrazhdësia ndaj fëmijëve mos t'i kalojë kufijtë

Kjo ndodh me rrahje të tepruar kur ata gabojnë, qoftë edhe për herë të parë ose duke i qortuar për çdo vepër, e madhe apo e vogël qoftë, si dhe me llojet e tjera të vrazhdësisë.⁶

8. Koprracia e tepërt ndaj tyre

Disa prindër janë dorështrënguar ndaj fëmijëve të tyre më shumë sesa që e kërkon nevoja, vepër që i bënë ata ta ndiejnë veten neglizhentë. Një sjellje e tillë i nxitë fëmijët që të kërkojnë pasuri në forma të ndryshme jolegjitime, si me vjedhje, duke kërkuar prej njerëzve ose duke u shoqëruar me vjedhësit apo me kriminelët.

9. Mungesa e dashurisë, butësisë dhe e mëshirës prindërore

Nëse te fëmija mungojnë këto elemente, atëherë ai detyrohet t'i kërkojë ato jashtë shtëpisë, me shpresë se dikush do t'ua ofrojë ato.

10. T'i kushtohet vëmendja vetëm çështjeve sipërfaqësore

Shumë njerëz mendojnë se edukimi i mirëfilltë është i kufizuar në ushqim të këndshëm, pije të freskëta, veshmbathje të bukur, në mësim të shkëlqyeshëm dhe në paraqitjen elegante para njerëzve, mirëpo assesi nuk e përmendin zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në frymën e vërtetë fetare.⁷

11. Teprimi në të qenurit mendim mirë ndaj fëmijëve

Disa prindër e teprojnë duke menduar vetëm pozitivisht për fëmijët e tyre, ashtu që ata nuk pyesin aspak për ta, nuk i kontrollojnë rrethanat e tyre dhe nuk dijnë asgjë për shokët e tyre. E gjithë kjo është pasojë e bindjes së tepruar ndaj tyre, domethënë edhe nëse fëmija i tij sjell ndonjë problem ose devijon nga rruga e drejtë, ai ia tërheq vërejtjen në lidhje me atë çështje dhe fillon ta mbrojë atë duke ia arsyetuar veprimet, ndërsa në anën tjetër e akuzon atë që e ka këshilluar, duke i thënë që të mos shpejtojë dhe të mos ndërhyjë në gjërat që nuk i interesojnë.

12. Teprimi në të qenurit mendim keq ndaj tyre

Kjo është e kundërta e të parës. Pra, ka prej tyre që kanë mendim të keq ndaj fëmijëve të tyre dhe e teprojnë aq shumë, sa që i nxjerrin ata nga kontrolli. Çdoherë i përbuzin qëllimet e fëmijëve dhe nuk janë kurrë të bindur në ta. Fëmija i tillë ndien se prindi është pas tij në çdo lëvizje, kurse prindi nuk i mbikëqyrë gabimet dhe lëshimet e tij.

⁶ Ibrahim El Mushejkih, Etherul usreti fi salahil ebnai venhiraftihim, f. 22-23.

⁷ Nadheratun fil usretil muslimeti, f. 150.

13. Dallimi i disa fëmijëve nga të tjerët

Kjo është një dukuri që shpreh pakujdesi në edukimin e fëmijëve, pra ka disa njerëz që bëjnë dallim mes fëmijëve dhe nuk janë të barabartë në drejtësinë ndaj tyre, si në aspektin material ashtu edhe në atë shpirtëror. Gjithashtu, ka të tillë që i dallojnë fëmijët në dhurata, në përkëdhelje, në shaka etj. Një vepër e tillë mbjell xhelozë në mes fëmijëve dhe shkakton urrejtje mes tyre. Gjithashtu, i largon dhe ata ftohen njëri nga tjetri.

Dukuri tjetër që e bën dallimin mes fëmijëve është kur prindi i jep djalit të madh një shumë të hollash, i blen atij veturë, e marton atë, i blen tokë, madje ndoshta edhe ia ndërton shtëpinë, kurse kur i thuhet atij se cila është pjesa e të vegjëlve dhe vajzave, ai thotë se të vegjëlve do t'u japim kur të rriten, ndërsa vajzat do të martohen dhe do t'u mjaftojë kujdesi i burrave ndaj tyre.

S'ka dyshim se kjo fjalë është e padrejtë dhe e mohon drejtësinë mes fëmijëve. Kush i garanton këtij njeriu se do të jetojë derisa të rriten fëmijët e tij të vegjël? Kush i garanton atij se ata do të jetojnë derisa të rriten? Kush i garanton atij se ai do të vazhdojë të ketë pasuri derisa fëmijët të rriten? Pastaj, vajzat kanë të drejtën e tyre edhe pse martohen. Ajo që i takon prindit është që kur t'i japë ndonjërit fëmijë, ai duhet t'u japë edhe të tjerëve sasinë e njëjtë. Nëse nuk ua jep, atëherë ai duhet t'ua ruajë për më vonë, t'ia shënojë atij që merr diçka më shumë, t'ia llogarisë si borxh (huazim), ose t'ia heqë nga pjesa që i takon prej tashigimisë.

14. Lënia pas dore e fëmijëve që kanë nevojë për martesë

Disa prindër janë në mëdyshje rreth martesës së fëmijëve, edhe pse ata kanë nevojë dhe mundësi për këtë. Një veprim i tillë është i gabuar, është shkaktar për devijimin dhe për zhytjen e tyre në mëkat dhe nëpër cytje të ndryshme.

15. Vonimi i martesës së vajzave dhe tregtia me to

Ky është një gabim shumë i madh. Disa prindër e vonojnë martesën e vajzave të tyre, posaçërisht nëse vajza është mësuese ose e punësuar, prej së cilës familja përfiton të mira materiale. Pra, frikësohen se nëse do të martohet, ata do t'i humbin këto përfitime. Kurse disa të tjerë bëjnë tregti me vajzat dhe presin se kush do të martohet me të me çmim më të lartë. Kjo vepër është krim ndaj vajzave, ndoshta djemtë i humbin shpresat për t'u fejuar me to dhe largohen prej tyre, atëherë barrën e mëkatit do ta bartin prindërit e tyre.

16. Martesa e vajzave me ata që nuk kanë ekuivalencë

Shumë njerëz nuk kujdesen që vajzat e tyre të martohen me një njeri që ka fe dhe moral, por dëshirojnë që vajza e tij të martohet me një njeri që ka post ose pasuri, ose e marton me të afërmin e tij, pa marrë parasysh fenë dhe moralin e tij. Pa dyshim se kjo është gabim, teprim dhe humbje e emanetit.

17. Nënvlërësimi i vajzave

Para se kjo të jetë neglizhencë në edukatë, është mungesë në besim. Nëse All-llahu xh.sh. disa njerëzve u falë vajzë, ata ndjehen të nënçmuar dhe të turpëruar. S'ka dyshim se ky gjest është vepër që i takon injorancës dhe moralit të tyre. All-llahu i Lartësuar i ka nënçmuar këta njerëz me këto fjalë të Tij:

“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij prishet dhe bëhet plot mlllef. Fshihet prej njerëzve për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron bela e jo dhuratë prej Zotit). Mandej, (mendon) a do ta mbajë atë ashtu i përlulur, apo do ta mbulojë atë (të gjallë) në dhe. Sa i keq është ai gjykim i tyre.”

(En-Nahl, 58-59)

Sa e ngjashme është e sotmja me të kaluarën! Nëse viziton ndonjë spital të lindjes në vendet ku jetojnë myslimanë dhe ua hedh një shikim atyre të cilëve u kanë lindur vajza, do të shohësh nga fjalët dhe nga gjendjet e tyre një përputhshmëri dhe ngjashmëri të habitshme me të kaluarën dhe me gjendjen e injorantëve, për punën e të cilëve na ka treguar All-llahu xh.sh në Kur'an.⁸ Në disa spitale mund që të shohin se çka ka në mitrën e gruas para se ajo të lind, nëse në mitër është duke u zhvilluar fëmija mashkull, ata përgëzohen, ndërsa nëse është femër ata e ndjejnë veten të nënçmuar, ndoshta edhe pikëllohen. All-llahu na ruajtë!

Nënçmimi i vajzave është çështje e rezikshme, në të ka gjëra nga të cilat duhet të kemi kujdes. Ato janë:

- a) Kundërshtim i caktimit të All-llahut xh.sh.
- b) Mohim i dhuratës së All-llahut në vend të falënderimit për të dhe kjo mjafton që të biesh ndesh me hidhërimin e All-llahut xh.sh.
- c) Përngjasimi me moralin e injorantëve.
- d) Kjo është dëshmi për mendjelehtësinë, injorancën dhe për çrregullimin në mendje.
- e) Kjo është ngarkim i gruas për atë që nuk ka mundësi, sepse disa hidhërohen me gruan vetëm pse ka lindur vajzë.
- f) Në të ka nënçmim për gruan.

Për më tepër kërko nga FSHI...

Kontakt tel. 02 205 72 70, 205 72 71

www.fshi.edu.mk

⁸ Xhasim Fehid Dusiri, Savnul mukerremat biriajetil benat, f. 16.